



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br	89/22
Nr. i fq. / Br. st	- 5 -
Data / Datum	13.4.2022
KOMUNA VUSHTRRI OPSTINA VUCITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPSTINA VUCITRN

### PROCESVERBAL

**në mbledhja e III-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17 mars 2022 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloj në ora 11:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm:, Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Munguan: Melihate Basholli-Latifi (kryesues) dhe Lorik Maxhuni (anëtar).

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i komunës), drejtoret e drejtive, Haki Maloku nga zyra e kryetarit, si dhe nga sekretaria e kuvendit Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.*

Në mungesë të kryesueses, mbledhjen e hapi dhe e kryesoii Ilmi Azemi (anëtar më i vjetër i KPF-së), i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës –** kerkoi që të plotësohet rendi i ditës në mënyrë që për seancë të kuvendit të përgatitet materiali me kohë. Ai kerkoi që të futen në rend të ditës edhe këto pika:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdheve në Komunën e Vushtrisë;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës për lirim nga pagesa e takstsës për çerdhet publike;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve në bujqësi;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale;
- Shqyrtimi i Planit të punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrisë.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së –** theksoi se jemi në një situatë të palakmueshme, ku më shumë kemi pika shtesë dhe pa material sesa të rregullta. Disa prej tyre mund të kenë ndonjë urgjencë, kurse disa tjera mund edhe të shtyhen.

<Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore> dhe <Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrisë>, sipas meje këto dy pika duhet të shtyhen, sepse kjo po i bie që t'i kryejmë njëherë ndërtimet e pastaj t'i bëjmë hartat zonale.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – tha se pajtohet me Sylejmanin, sepse nuk kemi material që ta dimë se për çfarë bëhet fjalë. Lidhur me hartat zonale, ai tha se është shtyrë shumë dhe ai kërkoi të dihet një afat se kur përfundon.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – lidhur me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ai tha se kemi pasur raste edhe në të kaluarën që i kemi trajtuar me urgjencë nëse bëhet fjalë për ndonjë grant qeveritar që për vonim të procedurave mund ta humb grantin.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – tha se pajtohet me anëtarët e kuvendit që ka mungesë materiali, sepse materiali është dashur të përgatitet. Por, ai theksoi se janë shumë pika të rëndësishme që mirë është të procedohen për kuvend dhe unë insistova që të sjellen në KPF në mënyrë që për kuvend mos të vonohen. Ai sqaroi rëndësinë e këtyre pikave: <Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës për lirim nga pagesa e taksës për çerdhet publike>, tha se është kthyer nga Ministria e Arsimit dhe po kërkojnë lokacionin e saktë se ku do të ndërtohen këto çerdhe.

<Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve në bujqësi>, kjo ndoshta mund të pres, por është mirë që të plotësohet kjo rregullore meqë pashë që ishin disa defekte.

<Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore>, tha se pronari ka kërkuar që ta zhvendosë mullirin në Mihaliq.

<Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë>, lidhur me këtë, ai tha se kemi pasur një takim me ekspertët dhe UNHABITAT-in dhe u kërkua që të shtyhet afati dhe asgjë nuk fshihet prapa kësaj. Por, qëllimi është që të mbahet një diskutim publik edhe me shoqërinë civile.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës** – lidhur me hartat zonale, ai theksoi se vendimi për shtyrje të afatit ka qenë deri në mars të këtij viti, ku ka qenë e planifikuar që të shkojë në ministri. UNHABITAT-i ka kërkuar që të shtyhet, kjo është aryseja.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – deklaroi se pas sqarimeve nga ana e qeverisë komunale, do t'i përkrahim pikat shtesë që t'i procedojmë në kuvend.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

#### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14.2.2022;
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomike – financiare dhe zbatimin e planeve investuese, si dhe i punës së Kryetarit të komunës – ekzekutivit për vitin 2021;
3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdheve në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës për lirim nga pagesa e taksës për çerdhet publike;

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvacioneve në bujqësi;
  8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale;
  9. Shqyrtimi i Planit të punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;
  10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
  11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë;
  12. Të ndryshme.
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14.2.2022.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 14.2.2022.*

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomike – financiare dhe zbatimin e planeve investuese, si dhe i punës së Kryetarit të komunës – ekzekutivit për vitin 2021.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – meqenëse kësaj qeverie nuk i atribuhet ky raport, është për keqardhje dhe shqetësuese numri i madh i kontratave që nuk janë inicuar fare dhe mjetet financiare kanë shkuar në suficit, kurse projektet si pasojë e kësaj nuk janë realizuar. Ai tha se nuk është inicuar teknologjia informative, e ne kemi shumë shkolla që nuk kanë mjaftueshmë teknologji informative në laboratore. Çdo vjet kemi problem me zjarrin dhe djegien e pyjeve, e në anën tjetër nuk kemi furnizim me aparate kundër zjarrit që nuk është inicuar fare. Inventarizimi i qendrës së kulturës nuk është inicuar fare procedura. Ai tha se në një situatë pandemie, furnizimi me veshmbathje, mantila, kapela, maska, papuqe për punëtorë nuk është inicuar fare procedura. Furnizimi me makina për mbjellje të misrit, pastaj serrave, pemishteve nuk është inicuar fare dhe e dimë sa kanë nevojë bujqit. Pastaj furnizimi me oksigjen është inicuar, por nuk ka pasur sukses. Si guxojmë të rrezikojmë që ta lëmë shërbimin e urgjencës pa oksigjen në një situatë pandemie, ku e prek direkt shërbimin respirator, ku njerëzit lypin çdo ditë boca me oksigjen. Pastaj, furnizimi me material shpenzues për laborator, ku laboratori ka mbet vetëm me dy parametra, nuk ka ndodhur furnizimi. Ai tha po ashtu që është obligim ligor që dy herë në vit institucionet publike ta bëjnë dezinfektimin, deratizimin dhe dezinsektimin dhe kjo procedurë nuk është inicuar.

Mehollı deklroi se ky është një dështim total i atyre që e kanë udhëhequr prokurimin dhe qeverisjen komunale gjatë vitit 2021, ndërsa sa i përket raportit, është i hartuar mirë dhe i detajuar. Shpresoj që në vitin 2022 nuk do të shkojë aq shumë buxhet në suficit dhe do të realizohen nevojat e institucionit.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – tha se nuk dua të hyjë në detaje sikur parafolësi, por ta procedojmë në kuvend e pastaj atje diskutojmë më gjerësisht për problemet e qytetarëve, sepse problemet në shëndetësi nuk janë vetëm në vitin 2021, por këto na përcjellin me vite të tëra.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

3. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – deklaroi se përveç tabelave e statistikave, duhet të bëhet një informatë më e detajuar dhe analitike. Pra, ta kemi një përshkrim të gjendjes lidhur me nivelin e cilësisë, por edhe të problemeve dhe sfidave për secilën shkollë.

**Miradije Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë për Arsim** – pajtohem edhe unë që ka nevojë të plotësohet me ato që i tha parafolësi, ndërkaq sa i përket shkollave, ajo tha se ndoshta në një seancë të veçantë mund të flitet për këtë çështje. Tuttje tha se kjo informatë është përgatitur shumë shpejt, por për kuvend do të plotësohet.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdheve në Komunën e Vushtrrisë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës për lirim nga pagesa e taksës për çerdhet publike.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

9. Shqyrtimi i Planit të punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë.

**Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** – theksoi se fillimisht drafti do të shkojë në ministri që t'i martë komentet, pastaj do të shkojë në konsultim publik, ku është një afat prej një muaj, pastaj përfshirja e komenteve nga konsultimi publik. Në fund tha se afati më optimal do t'ishte në muajin dhjetor.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

12. Të ndryshme.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – kërkoi nga Drejtoria për Inspektime që t'i rrit inspektimet në të gjithë sektorët ku përdoret mishi (e pamë rastin në Pejë) dhe ta shohim se a kemi mish të tillë në komunën tonë.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se drejtoresha e Drejtorisë për Inspektime nuk qenka këtu, por inspektimet sanitare më nuk janë në kompetencë të komunës, por ka kaluar në nivel të regionit dhe AUV-it.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – tha se bizneset ende bëjnë kërkesë në komunë për t'u pajisur me pëlgjime sanitare. Kisha kërkuar që mos t'ju pranohen fare këto kërkesa se nuk janë në kompetencë të komunës dhe nuk e di qysh procedohen këto kërkesa.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** – deklaroi se prej momentit që inspektimi sanitari ka kaluar në AUV, ne nuk kemi përgjegjësi. Ne palët nuk do t'i pengojmë që të bëjnë kërkesë, por do të shikojmë si ta zgjidhim këtë çështje.

**Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** – tha se i ka dërguar e-mail për këtë çështje kryeinspektorit për inspektime sanitare, por që nuk kam ende përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën **11:55**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës



Ilmi Azemi  
Anëtar i KK-së dhe KPF-së